



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V-të

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 30.

Prishtinë, më 03.11.2015 në orën 13:00.

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2.

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Slllobodan Petroviq, Vjosa Osmani, Rustem Mustafa, Luljeta Veselaj -Gutaj, Arben Gashi, Ilir Deda dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Valdete Bajrami, Xhavit Haliti dhe Time Kadriaj.

Emrat e të ftuarve dhe të pjesëmarrësve të tjerë: Samuel Zhbogar, Bekim Çollaku dhe Demush Shasha.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi, znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Rendi i Ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takimi informues me z. Samuel Zhbogar, udhëheqës i Zyrës së BE-së në Kosovë dhe përfaqësues Special i BE-së në Kosovë;**
- 3. Raportimi i z. Bekim Çollaku, ministër i Integrimit Evropian, për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Takimi informues me z. Samuel Zhbogar, udhëheqës i Zyrës së BE-së në Kosovë dhe përfaqësues Special i BE-së në Kosovë

Kryetarja—Shprehkënaqësinë që një ditë më parë u miratua në Kuvendin e Kosovës, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA). Gjithashtu, i dëshiroj mirëseardhje në Komision, z. Zhbogar dhe e falënderoj për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme gjatë gjithë procesit të negociimit të kësaj marrëveshjeje.

Samuel Zhbogar—Uroj Kuvendin e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës për ratifikimin e MSA-së dhe vlerësoj si një hap të rëndësishëm në rrugën e Kosovës drejt integritetit në BE. Shpreh pakënaqësinë për mospjesëmarrjen e opozitës gjatë procesit të votimit të MSA-së në Kuvend. Kam shpresuar se MSA-ja do të jetë si pikë kthese e opozitës në Kuvend.

Lidhur me punën e Kuvendit, kërkoj që të ketë një dialog politik dhe të normalizohet puna e Kuvendit të Kosovës. Veprimet e opozitës i cilësoj si jodemokratike. Kurse nga Qeveria e Kosovës, kërkoj gatishmëri për të qenë më transparent në punën e saj. Sa i përket MSA-së Marrëveshja e Stabilizim Asociimit është një marrëdhënie kontraktuale e ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian, duke e cilësuar si shumë të rëndësishme.

MSA-ja për Kosovën është gjithëpërfshirëse dhe nuk dallon nga atotë vendeve të tjera të rajonit, por ajo është e ndryshme, sipas specifikave të tilla çfarë ka Kosova. Procesii MSA-së, ka filluar që nga viti 2012 kur Bashkimi Evropian ka vendosur për studimin e fizibilitetit për Kosovën, dhe me këtë studim, u konfirmua se Kosova mund të fillojë përgatitjet për fillimin e negociatave për MSA-në. Në vitin 2014 MSA-ja është iniciuar nga negociatorët e saj, kurse në këtë vit është finalizuar me nënshkrimin e saj, në tetor të vitit 2015.

Sa i përket ratifikimit të MSA-së nga ana e BE-së, kjo do të bëhet nga institucionet e Bashkimit Evropian, që do ta ratifikojnë në emër të të gjitha shteteve të tij. Pra, Traktati i Lisbonës lejon një gjë të tillë dhe sigurisht është një mundësi e mirë në dobi të Kosovës.

Po ashtu, z. Zhbogar foli edhe rreth strukturës së MSA-së, ku parashihet formalizmi i dialogut në mes BE-së dhe Kosovës, përmes krijimit të mekanizmave, siç janë: Këshilli i Stabilizim-Asociimit, Komiteti i Stabilizim-Asociimit, Nënkomitetet e Stabilizim-Asociimit dhe Komisioni i Përbashkët Parlamentar i Stabilizim-Asociimit. Në këtë proces, Kuvendi i Kosovës do të ketë një rol të rëndësishëm, kryesisht në dy nivele: e para, viza-vie Parlamentit Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes, dhe e dyta, ndaj institucioneve të Kosovës për zbatimin e të gjitha politikave që dalin nga kjo marrëveshje. Pra, Komisioni për Integritet Evropian, pas ratifikimit të MSA-së, duhet të reflektojë për të kërkuar një rol më të madh lidhur me zbatimin e saj, përmes një plani të veprimit në Kuvend, sa i përket zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Kryetarja—Me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, shpresoj se do të hapet një mundësi e re e bashkëpunimit të Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian dhe do të hapet mundësia e reformave të ndryshme. Sa i përket rolit të Komisionit për Integritet Evropian, do të zgjerohet edhe më shumë, si në analizimin e legjislacionit, kontrollit të tabelave të përputhshmërisë, zbatimin e legjislacionit, etj. Shpresoj se ky dokument i rëndësishëm shumë të madhe do të sjellë edhe opozitën brenda në Kuvend dhe të vazhdojë dialogu, ashtu siç duhet të jetë, dialog konstruktiv me zë të fuqishëm opozitar. Integriteti ka qenë një proces në të cilin nuk kemi pasur opozitë dhe shpresoj shumë që ky proces të na bashkojë në vazhdimin e punës sonë të mirëfilltë. Pyeti: A shihni ndonjë pengesë eventuale, e cila do të ndikonte në zvarritjen e miratimit të MSA-së nga ana e Institucioneve të BE-së? Duke pasur parasysh rëndësinë e nënshkrimit dhe ratifikimit të MSA-së, ne si vend marrim obligime për fillimin e reformave. Në këtë aspekt, do të doja të jemi të informuar për rolin e Zyrës suaj në dhënien e ndihmës në procesin e reformave të vendit tonë. Me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, përcaktohet themelimi i Këshillit të

Stabilizim-Asociimit (KSA). A do të jetë e përfaqësuar Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë në Këshillin e Stabilizim-Asociimit dhe çfarë roli do të ketë?

Cila do të jetë sfida më e madhe për institucionet e vendit tonë lidhur me zbatimin e MSA-së?

Rrustem Mustafa– Falënderoj z. Zhbogar për kontributin e dhënë për Kosovën, në çështjet që kanë të bëjnë për rendin, ligjin dhe edukimin. Ne, si komision, kemi tërhequr vërejtjen edhe më herët për qasjen e komunikimit ndërqeveritar që nuk e kemi të mirë, pra komunikimin Qeverisë me media, por edhe me qytetarët. Pasi përfaqësoni një zyrë me kredibilitet të lartë, kërkoj që përveç shtyllave më të rëndësishme të vendit, të na ndihmoni me kapacitete këshillëdhënëse, që të mësoni Qeverinë dhe institucionet tjera për komunikim mëtëmire mes vete. Po ashtu, të bëhet një strategji për komunikim me qytetarët nga institucionet, për çështjet siç është demarkacioni i kufirit me Malin e Zi dhe bashkësia (asociacioni) e komunave serbe.

Vij nga pozita dhe e di se kjo qasje e opozitës nuk iu pëlqen as atyre, sepse ato mënyra janë të tejkaluara, andaj besoj se nuk do të përsëriten më. Sa i përket marrëveshjeve me Serbinë, ka pasur pak shpjegime për marrëveshjet. Jam i sigurt se bashkësitë e komunave kanë një lidhje rajonale mes vete, përafërsisht sikur ndërtimi i rajoneve në Kosovë, si shembull kemi Prishtinën me tri, katër komuna përreth, që quhen rajon, të cilat më vonë do të mund të krijojnë bashkëpunim më të afërt mes tyre.

Ilir Deda –Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është mundësi për rregulla të reja të lojës dhe forcim i demokracisë në Kosovë. Ne kemi evokuar për rëndësinë e miratimit të MSA-së. E kemi parë si shpresë të kulturës së mosndëshkimit institucional në Kosovë, e cila ka ekzistuar me vite dhe në forcimin e institucioneve të zhvillimit të rendit dhe ligjit. Gjatë vitit të kaluar, në kohën e krizës politike në Maqedoni, ishte pikërisht Komisionari Hahn, i cili shkoi dhe ndërmjetësoi një dialog politik ndërmjet katër partive politike atje. Kjo, sepse dialogu politik në mes Qeverisë dhe opozitës, është vlerë demokratike. Mendoj se duhet të ketë sa më shumë mesazhe publike se është i rëndësishëm dialogu në mes pozitës dhe opozitës për zgjidhjen e krizës politike.

Do të ishte më mirë për pozitën e Kosovës që mos të ketë nevojë për ndërmjetësim të Brukselit, por zgjidhjen e krizës ta gjenim ne vetë, me dialog politik. Jukritikuat kolegët e mi nga opozita, por mendoj që nuk jemi në gjendje të tillë ku do të kërkohej fajtori, por të kërkohej zgjidhje dhe këto zgjidhje duhet të jenë pjesë e një konsensusi tëgjërë politik. Ajo që e kompletonte MSA-në është edhe marrëveshja Kornizë Komunitare. Në çfarë periudhe kohore mund të presim që të vijë deri te nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje?

Vjosa Osmani–Falënderoj z. Zhbogar për prezencën e tij në këtë Komision, po ashtu nënvizoj rëndësinë e ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në Kuvend. Dje, gjatë debatit që u zhvillua në seancë, u dëshmua që ka jashtëzakonisht pak informata rreth natyrës së këtij dokumenti dhe interpretimit të pjesës politike. Fatkeqësisht, në vend që të fokusoheshim tek pjesa tregtare dhe përfitimet në fushat e tjera, siç janë sundimi i ligjit, në seancën gjithë debati u zhvillua për pesë gjashtë nenet e para të MSA-së. Pikërisht, kjo se ka munguar qoftë një kampanjë vetëdijësimi, qoftë një komunikim siç u tha më herët. Madje, edhe neve si Komision, na u është mohuar e drejta që të shohim MSA-në deri pak ditë para se të vijë ajo. Sa i përket MSA-së, më vjen mirë që ju e konfirmuat sot një gjë, që dje në seancë kishte dilema. Pra, që kjo MSA themelon marrëdhënie kontraktuale në mes të Kosovës dhe BE-së, që ka substancën e njëjtë sikur MSA-të e rajonit, por ndryshon, sepse BE-ja funksionon në bazë të mësimave të mësuaradhe praktikave të mëhershme, qofshin ato që kanë pasur sukses, qofshin ato që s'kanë pasur sukses. Duke pasur parasysh mosnjohjen e Kosovës nga pesë shtetet anëtare, ka nene specifike që i referohen atyre pesë shteteve, por në asnjë mënyrë, kjo MSA, nuk e mohon faktin që kemi 23 shtete të tjera që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Në mënyrë që të arrijmë që t'i bëjmë hapat e parë drejt një unitetit politik, që ka ekzistuar në fushën e integritetit evropian, na duhen sa më shumë takime të tilla dhe sa më shumë angazhim pozitiv nga ana e juaj dhe zyrtarët e tjerë të BE-së, me të gjithë liderët e partive, që në radhë të parë të kuptohet mirë MSA-ja. Dialogu politik në mes pozitës dhe opozitës, sot në Kosovë, nuk është vetëm vlerë demokratike,

por është domosdoshmëri. Është e pamundur të funksionojmë në mënyrë normale më tej në qoftëse thjeshtë tregojmë cili është problemi pa vendosur që së bashku të ulemi dhe ti zgjedhim këto probleme. Pyeti, nga praktikantët që ju i keni parë deri më tani me shtetet e rajonit dhe duke pas parasysh përvojën tuaj personale çka do ti rekomandonit ju Komisionit për Integrim Evropian në këtë moment politik në të cilin grindemi dhe nëse ju mendojnë që një rol i rritur dhe më i avancuar i Komisionit në këtë moment politik mund të ndikojë së paku në fillimin e zgjidhjes së problemit sepse MSA-ja, apo pjesë të caktuara të saj që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, me dialogun si vlerë demokratike, si vlerë institucionale nuk do të mund të implementohen. Në qoftë se detyra jonë si Komision është implementimi i këtyre pjesëve, atëherë ne jemi të bllokuar. As dje, ne nuk arritëm, sepse ka qenë detyrë e të gjithë neve që të kontribuojmë që dje të jemi aty bashkë në votimin e këtij dokumenti. Pra, nëse nuk kemi arritur as dje që gjatë ratifikimit të bëhemi bashkë, natyrisht që nuk do të arrijmë as gjatë implementimit të bëhemi bashkë.

Kryetarja—Për korrektësi, dokumenti i MSA-së ka qenë në versionin anglisht, që është shpërndarë deputetëve në mënyrë jozyrtare, ndërsa më vonë kur e kemi pranuar në gjuhë zyrtare, ua kemi shpërndarë edhe përmes email-it, dhe tani së fundmi, ka ardhur versioni i fundit dhe iu është shpërndarë zyrtarisht.

Samuel Zhbogar— Iu përgjigj pyetjeve të parashtruara.

Sa i përket këndvështrimit të situatës politike në Kosovë dhe asaj në Kuvend, veprimet e opozitës i quajti të papranueshme për Bashkimin Evropian, sepse veprimet e tyre, siç është gjuajtja me vezë, shishe me ujë dhe gaz lotsjellës, sipas tij, janë veprime të papranueshme dhe jo-demokratike. Veprimet si këto të opozitës, nuk kemi pasur rast t'i shohim askund në Evropë, prandaj kjo është arsyeja edhe pse ne publikisht i dënojmë këto veprime dhe kritikojmë haptazi opozitën. Nëse dikush nuk i përgjigjet thirrjes së organeve të rendit, ky nuk është zbatimi i ligjit, andaj ne duhet të pyesim veten se për çfarë zbatimi të ligjit po mendojmë. Pajtohem se ka nevojë për një dialog politik dhe pajtohem se ka vend për komunikim mes Qeverisë dhe partive politike. Ne nuk e fajësojmë vetëm opozitën, por që zgjidhja duhet të ndodhë sa më shpejt që të jetë e mundur për normalizimin e punës së Kuvendit. Vetë nënshkrimi i MSA-së ka zgjatur një vit dhe Kosova nuk ka kohë për të humbur. Kam menduar se kjo marrëveshje do të hapë derën për komunikim. Në këtë rast, Presidentja ka luajtur rolin e saj, ku ka dërguar Marrëveshjen në Gjykatën Kushtetuese. Ky është rast që mund të shfrytëzohet për të zgjidhur situatën politike përmes dialogut. Ka shumë projektligje, të cilat do të duhej të miratoheshin në këtë periudhë, siç është ai i prokurimit publik, çështjeve ekonomike dhe disa të tjera, të cilat janë të rëndësishme për procesin e liberalizimit të vizave. Nuk mendoj se ju duhet një ndërmjetësues për zgjidhjen e kësaj situate, sepse nuk jeni në gjendjen e njëjtë në të cilën ishte Shkupi disa muaj më parë. Ne si ndërmjetësues të marrëveshjeve, nuk bëjmë interpretimin e tyre, por dihet se kur njëra palë e sheh si fitore një proces, pala tjetër automatikisht e sheh si dështim. Sa i përket komunikimit për marrëveshjet, tha se ka mundësi të ketë komunikim shumë më të mirë dhe të shpjegohet se çka janë këto marrëveshje, çka rregullohet me to etj. Jemi duke pritur opinionin e Gjykatës, andaj le të shohim se cili do të jetë opinionin e tyre. Ne duhet të respektojmë çfarëdo opinionin që vjen nga Gjykata. Sa i përket demarkacionit me Malin e Zi, tha se është çështje e mungesës së informatave. Kryeministri është i gatshëm që të paraqesë informatat dhe hartat e sakta, lidhur me këtë proces, si dhe të gjithë atyre të cilët po prezantojnë hartat të ndryshme. Sa i përket Marrëveshjes Kornizë të Komuniteteve, kemi pritur që të përfundojë MSA-ja, sepse përmes MSA-së, e kemi mënyrën si të arrijmë së shpejti edhe atë marrëveshje. Si sfida më e madhe e Kosovës, i shohim prodhuesit vendorë, pasi që me MSA-në do të bëhet liberalizimi i tregut dhe dhjetë vite do të shkojnë shumë shpejt, andaj duhet të punohet në drejtim të forcimit të prodhuesve vendorë, në mënyrë që të jenë të gatshëm të eksportojnë produktet e tyre në Evropë dhe të konkurrojnë me produktet të cilat ngadalë do të hyjnë në tregun kosovar. Sa i përket përfitimeve që do t'i kenë qytetarët e Kosovës nga MSA-ja, tha se qytetarët e Kosovës do të kenë

beneficione nga standardet të cilat kërkohen të plotësohen, sepse edhe standardet për ushqim duhet të plotësohen dhe do të ketë më shumë kontroll të tyre.

Sllobodan Petroviq– Falënderoi për prezencën e tij në Komision dhe për kontributin e dhënë në të kaluarën. Gjithashtu, tha se dje është përfunduar një marrëveshje e rëndësishme dhe Kosova është një mjedis, të cilën e presin shumë sfida të mëdha.

Kryetarja falënderoi të gjithë që kanë kontribuar në këtë Komision parlamentar, si pozitë dhe opozitë, të gjithë kanë qenë konstruktivë në procesin e integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në procesin, deri në nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Luljeta Gutaj-Veselaj–Falënderoi. Zhbogar-in për prezencën e tij në Komision. Pyeti: A do të ketë Kosova vështirësi nga ato vende të cilat nuk janë përkrahëse të Kosovës në këtë proces dhe si do të kalohet ky problem?

Vjosa Osmani–Ju e dini si funksionon Komisioni i Venedikut, sepse një herë para se Kosova të anëtarësohej në këtë Komision, kemi dërguar një kërkesë që të analizojë Ligjin për liritë fetare dhe përgjigjen e patëm marrë shumë shpejt. Në bazë të atyre rekomandimeve, siç e dini, ne e kemi një propozim të ri të ligjit për liritë fetare. A nuk mendoni se Kosova tanimë si anëtare e këtij Komisioni e ka tani momentin që të utilizojë këtë Komision tërësisht profesional, i cili për momentin mbetet i vetmi institucion, të cilit i beson Qeveria dhe opozita dhe për të cilin janë deklaruar për të se do t'i respektonin në tërësi opinionet e tyre për cilindo dokument që do të dërgohet nga ana e institucioneve të Kosovës atje. Nëse zgjidhja është kaq e lehtë, pse nuk po shfrytëzohet, kush po i frikësohet këtij Komisioni? Unë nuk po e kuptoj! Muajve të fundit, kemi deklarime, qoftë nga zyrtarët e pozitës, qoftë nga të opozitës se do t'i besonin këtij Komisioni. Ju e dini shumë mirë pse sot ka parti politike që nuk i besojnë Gjykatës Kushtetuese. Nuk them që është praktikë e mirë, përkundrazi është praktike shumë e dëmshme, pasi që nuk kemi së paku një institucion në Kosovë, të cilit i besojnë të gjithë, duke përfshirë edhe qytetarët. Mirëpo, ky është një realitet të cilin nuk mund ta mohojmë.

Samuel Zhbogar–Ju përgjigj pyetjeve të anëtarëve të Komisionit, duke thënë se pesë vendet anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën si shtet, nuk kanë bërë problem ose penguar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit për Kosovën dhe nuk besoj se do të bëjnë probleme në implementimin e saj. Në rastin e dialogut politik, Kosova duhet të shfrytëzojë të gjitha mundësitë e brendshme dhe institucionet e saj, për të gjetur zgjidhje politike. Nuk do të anashkaloja Gjykatën, sepse dikush nuk e pëlqen për një arsye të caktuar apo për ndonjë vendim të vitit të kaluar. Gjykata Kushtetuese, si institucioni më i lartë për mbrojtjen e Kushtetutës, duhet të shfrytëzohet sesi do të veproni. Unë nuk kam dhe nuk do të duhej të kem ndonjë opinion rreth kësaj, sepse është çështje e juaja e brendshme. Nuk duhet të eksportoni problemet e juaja të brendshme jashtë vendit, por ato duhet t'i zgjidhni brenda Kosovës dhe nuk duhet të kërkoni zëvendësimin e Gjykatës Kushtetuese në Komisionin e Venedikut. Për këtë rast konkret, nuk kam ndonjë opinion konkret, mirëpo keni Gjykatën Kushtetuese funksionale, ku janë edhe gjyqtarët ndërkombëtarë, të cilët do ta bëjnë më kredibile këtë Gjykatë.

Vjosa Osmani –Ndërhyri duke thënë se dërgimi i kësaj çështjeje në Komisionin e Venedikut nuk është çështje e eksportim, por çështje e domosdoshmërisë, sepse po humbim 60 ditë dhe në rastin e krizave të tilla politike koha është tepër e rëndësishme. E nëse kemi kohë për të humbur 60 ditë, e që unë mendoj se nuk kemi, sepse siç e përmendet, ne kemi buxhetin që duhet të miratohet tash në nëntor dhe kemi një mundësi që do të na lejonte të miratonim atë bashkë me opozitën në sallë, atëherë nuk është çështje e eksportimit të çfarëdo problemi, por është çështje e zgjidhjes së problemit. Dhe, kur zgjidhja është këtu e mos të shfrytëzohet, tregon mosgatishmëri për ta zgjedhur problemin. E atë mosgatishmëri nuk kemi nevojë ta tregojmë as pozita, as opozita e as partnerët tanë ndërkombëtarë. Në ditën kur Republika e Kosovës është bërë anëtare

e Komisionit të Venecias, nuk është anëtarësuar për të eksportuar probleme, por për të shfrytëzuar për zgjidhjen e problemeve që janë të pazgjidhshme në Kosovë. E fatkeqësisht, kjo është një prej tyre.

Ilir Deda –Komisioni i Venedikut, ende pa qenë Kosova anëtare e tij, ka marrë pjesë në hartimin dhe amendamentimin e Kushtetutës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese nuk ka ekzistuar në atë kohë. Ne jemi në këtë situatë, për shkak të politikave të gabuara të cilat kanë ekzistuar në Kosovë me vite. Tash, kur finalja e këtyre gabimeve është kriza e tillë politike, mund të themi që është Komisioni i Venedikut, ai i cili mund të japë përgjigjedhe të pranohet prej të gjithëve për problemin politik të cilin e kemi. Pra, problemi politik është interpretimi i marrëveshjeve të cilat lirisht mund të themi se nuk janë në përputhje me *acquis* të BE-së, e që ne e kemi obligim ta zbatojmë prej ditës së djeshme.

Samuel Zhbogar –Në fund të takimit, falënderoi anëtarët e Komisionit për ftesën dhe për bashkëpunimin.

Kryetarja e falënderoi për takimin, z. Zhbogar dhe tha se Komisioni do të vazhdojë me pikën e radhës të rendit të ditës.

3. Raportimi i z.Bekim Çollaku, ministër i Integrimit Evropian, për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit

Kryetarja, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi pjesën e dytë të mbledhjes. Falënderoi ministrin që çdo herë i përgjigjet ftesës së Komisionit dhe njëherazi i uroi për miratimin e MSA-së, si një proces shumëvjeçar që përfundoi dhe fillimii proceseve tjera që dalin nga MSA-ja. Ka qenë e paraparë që me ju të diskutojmë për dokumentin e MSA-së, por do ta shfrytëzojmë praninë e juaj që të diskutojmë për hapat që do të pasojnë pas miratimit të MSA-së. Në vazhdim, ia dha fjalën ministrit.

Ministri Çollaku –Jufalënderoj për ftesën dhe për mundësinë që të diskutojnë bashkë për MSA-në dhe njëherazi falënderoj Komisionin për Integritime Evropiane, në kuadër të Kuvendit të Kosovës për një punë të përshpejtuar dhe për amendamentet e qëlluara në ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Në vazhdim, tha se nga dita e ratifikimit nuk është më asgjë e njëjtë në raport me Kosovës dhe BE-së. Tani, gjithçka është konkrete dhe zyrtare dhe perspektiva jonë nuk mund të vihet në pikëpyetje nga askush.

Kryetarja theksoi se si Komisioni i Integritimeve Evropiane, do ta kemi një rol shumë më të rëndësishëm dhe do të kemi më shumë punë në Komisionin tonë. Gjithashtu, me MSA-në parashihet krijimi i një komisioni të veçantë për MSA-në, ku do të përbëhet nga anëtarët e Komisionit për Integritime dhe do të ketë edhe anëtarë tjerë, si dhe do të kemi mundësi të bashkëpunojmë në mënyrë më të theksuar. Në vazhdim, pyeti ministrin për hapat e ardhshëm të MSA-së, për ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit dhe kapacitete për përafrimin gradual të legjislacionit me BE-në, për tabelat e përputhshmërisë me *Acquis* dhe njohuritë për to. Pra, ato do të jenë në gjuhën angleze, dhe si të tilla, ne e kemi të vështirë që t'i procedojmë në Kuvendin e Kosovës, sepse i pranon dokumentet në gjuhët zyrtare të Kosovës, por së paku do të ishte mirë të informohemi edhe në gjuhën angleze, në mënyrë që të jemi të përgatitur për fazën që do të vij, nëse mund të bëhet përkthimi dhe nëse ka kapacitete për përkthim. Në cilat fusha do të përqendrohet? E dimë se tregu i brendshëm, siguria dhe drejtësia, tregtia janë fusha që do të marrin shumë energji, si nga ana juaj, po ashtu edhe nga ne.

Pyetja tjetër ka të bëjë me përgatitjen institucionale për absorbimin e fondeve të IPA-së. E dimë se mbi 600 milion janë fonde të parashikuara për Kosovën dhe pjesa më e madhe e absorbimit të tyre varet prej kapaciteteve tona.

Në fund, kërkoi nga ministri të njoftojë për rekomandimet për liberalizimin e vizave dhe për adresimin e të gjitha rekomandimeve në institucionet përgjegjëse.

Ministri Çollaku, në fjalën e tij, theksoi se ishte përgatitur të raportonte në Komision para ratifikimit të MSA-së, por pasi që kjo tanimë është miratuar, do të përqendrohet vetëm në hapat që duhen ndërmarrë dhe përqendrimin në mekanizmat institucionalë që duhet ngritur për zbatimin e marrëveshjes.

Ai, fillimisht, u pajtua me konstatimin e kryetares së Komisionit, Teuta Sahatqija se Komisioni për Integritet Evropian do të ketë rol shumë të fuqishëm për zbatimin e MSA-së dhe për harmonizimin e legjislacionit të vendit me atë të BE-së. Sa i përket çështjes se ku kemi mbërri me përgatitjet, e dini se me fillimin e mandatit të qeverisjes, Ministria e Integritetit Evropian ka prioritet parësor përgatitjen e Planit kombëtar për zbatimin e MSA-së. Me ndihmën e ekspertëve nga shtetet e rajonit, Ministria është në fund të përfundimit të Planit kombëtar për zbatimin e MSA-së, dhe me këtë plan kombëtar, janë përfshirë të gjitha trupat dhe mekanizmat institucionalë dhe të gjitha masat që duhet t'i marrim si Republikë e Kosovës, në mënyrë që të jemi të gatshëm për zbatimin e MSA-së, që presim të fillojë diku nga fillimi i vitit të ardhshëm dhe pas kryerjes së procedurave që kanë mbetur nga BE-ja.

Sa i përket hartimit të legjislacionit, ne nuk fillojmë nga pika zero në këtë aspekt. Edimë se të gjitha ligjet tona kalojnë në një proces të skanimit dhe të shikimit se a janë të përafërta me legjislacionin e BE-së, mirëpo pasi që do të futemi në një proces të ri, do duhej një skanim total i gjithë legjislacionit, por nuk mendoj se do të kemi pengesa teknike në këtë aspekt. Sa i përket përkthimit të legjislacionit, ne kemi bashkëpunuar ngushtë me ministrin e Integritetit Evropian të Shqipërisë dhe kemi përkrahjen edhe të shteteve të rajonit në përkthimin dhe përafrimin e legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së.

Sa i përket IPA-së, fondeve dhe kapaciteteve absorbuese të tyre, deri më tani nuk kemi pasur ndonjë rast, që për mungesë të projekteve, të kemi humbur nga këto fonde. Jemi në proces të përgatitjes së listës së prioritetëve primare të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për të thithur sa më shumë fonde nga BE-ja dhe një pjesë e këtyre mjeteve derdhen direkt në buxhetin e Kosovës. Për të arritur deri në këtë fushë, duhet të plotësohen disa kriteret dhe duhet të rritet transparenca. Pra, duhet të ketë projekte të qarta me studimin e fizibilitetit dhe duhet të ketë llogaridhënie të plotë.

Demush Shasha, sekretar në Ministrinë e Integritetit Evropian, sqaroi lidhur me tabelat e përputhshmërisë.

Baza dhe pikënisja e procesit për përafrimin, tash e tutje është një nga pikat nga të cilat MSA e ndryshon në tërësi kuptimin e asaj që tani është obligim i nenit 74 të MSA-së, që Kosova të sigurojë përafrim ligjor me legjislacionin e BE-së.

Në Kosovë, nga 1 janari i vitit 2014, ka hyrë një sistem i ri i përafrimit, ku janë bërë tabelat e përputhshmërisë të cilat tregojnë nën për nën se si është përafruar ky ligj dhe kjo është bërë me qëllim të përgatitjes për të zbatuar obligimet që do të vijnë, në kuadër të MSA-së.

Kuadri institucional dhe teknik është në dijeni se çka duhet tash e tutje. Është përafruar një akt ligjor në tërësi dhe substancialisht me direktivat dhe rregulloret e BE-së.

Arben Gashi, theksoi se ideja fillestare e thirrjes suaj dhe z. Zhbogar ishte që të paktën tri elemente të plotësohen.

Debati paraprak se çka është MSA-ja, cilat janë pikat e forta dhe të dobëta, dhe ju të na bindni ne, që të votojmë MSA-në. Kjo, sot, nuk ka relevancë, sepse ne e kemi votuar paraprakisht dhe dy pikat tjera kanë të bëjnë me informimin e publikut për këtë proces, benefitet dhe pikat e dobëta të mundshme dhe edukimi i atyre që janë të përfshiruar.

Çështjet tjera, tashmë janë tejkaluar dhe po debatojmë dhe më shumë po e përdorim një retorikë për të mbajtur bazën e diskutimit, por jo se do të jetë ai impakt real për MSA-në.

Ilir Deda—Ne si anëtarë të Komisionit, nuk kemi raport të ekspertëve të BE-së për liberalizim të vizave, sepse po përmenden ato 8 kritere të cilat ne nuk i kemi përmbushur, por realisht ne nuk i dimë cilat janë ato kritere të papërmbushura.

Pyeti: kur pritni të nënshkruhet Marrëveshja Kornizë për Komunitetet?

Ministri Çollaku u përgjigj duke thënë se më lehtë është të nënshkruhet Marrëveshja Kornizë për Komunitetet sesa MSA-ja, por ky ka qenë një pajtim mes Qeverisë së Kosovës dhe BE-së, në mënyrë që prioritet të jetë MSA-ja dhe jo qasjet në programet e BE-së, sepse votimi përsëri bëhet në Këshill, mirëpo bëhet me shumicën e thjeshtë dhe nuk kërkohet në mënyrë unanime votimi.

Krejt është gati, por Komisioni Evropian duhet të jetë në lëvizje dhe të njëjtën ta dërgojë për miratim në Këshillin e Evropës dhe pritjet të nënshkruhet jo gjatë këtij viti, por gjatë vitit të ardhshëm. Por, shtrohet pyetja se a jemi të gatshëm ne si Kosovë për të pasur qasje në këto fonde dhe nuk do të thotë se menjëherë pas nënshkrimit, ne do të kemi qasje në këto fonde, por së pari duhet të bëjmë marrëveshje mirëkuptimi me secilin fond dhe pastaj kjo i mundëson sektorit të caktuar të aplikojë për fonde për programe të ndryshme. Duhet informuar publikun se për çfarë fondesh bëhet fjalë, cilat janë kriteret që duhet të plotësohen që të aplikohet në këto fonde. Janë 32 dy programe dhe nuk ka asnjë pengesë për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

Në përfundim të fjalës së tij, lidhur me liberalizimin e vizave, ministri Çollaku theksoi se çështja e liberalizimit të vizave është çështje teknike, e cila nga fillimi ka qenë e kushtëzuar me plotësimin e kriterëve teknike, e që në rastin e Kosovës, ka qenë jo e drejtë dhe ai dyfishim i standardeve dhe ato kritere janë përmbushur që në qershor, por këto kërkesa shtesë që kanë dalë nga misioni vlerësues teknik dhe ky raport, nuk ka qenë nga Komisioni Evropian, por një raport i ekspertëve në nivel teknik, të cilët kanë qenë përfaqësues të Komisionit Evropian dhe shteteve anëtare.

Raporti i Komisionit Evropian për liberalizim të vizave ende nuk ka dalë, por së shpejti pritjet të përfundojë si raport dhe qarkullimi i tij në shtetet anëtare, por s'e di se kur do të na jepet mundësia me pas qasje në atë raport, por e dimë se do të jetë raporti i fundit i Komisionit Evropian, sa i përket përmbushjes së kriterëve për liberalizim të vizave. Afati kohor se kur mund që Komisioni Evropian ta bëjë publik rekomandimin për liberalizimin e vizave, është fundi i dhjetorit ose fillimi i vitit të ardhshëm, por pas marrjes së rekomandimit janë përsëri disa procedura brenda BE-së.

Sa i përket kriterëve shtesë, ato nuk janë kritere, por janë rekomandime shtesë me kritere të caktuara dhe dje ka qenë afati për dërgimin e imputeshës, të cilat do të jenë mjaft pozitive.

Ne e dimë se me çfarë krize refugjatësh është duke u ballafaquar BE-ja dhe ne e kërkojmë liberalizimin. Qeveria e Kosovës dhe Ministria, të cilën e udhëheq, po bëjnë shumë për kthimin e qytetarëve tanë, pa leje qëndrimi në vendet perëndimore, por ka theksuar gjithashtu se ua ka bërë të qartë se Kosova nuk mund t'i bartë pasojat e krizave që nuk i shkakton vet.

Kryetarja e komisionit i konsideron informatat që i dha ministri për liberalizimin e vizave si shumë të rëndësishme për qytetarët, por e konsideron shumë të rëndësishme edhe çështjen Grejstë periudhës 10 vjeçare, e cila do të ndihmojë bizneset tona që të adaptohen në kushtet e reja, të cilat i cek MSA-ja dhe mundësia e marrjes së fondeve të IPA-s, që janë 635 mil. € dhe mundësia që shpejt të kenë qasje në fondet e BE-së. Këto gjëra do të kërkojnë ngritje të kapaciteteve institucionale dhe ndihmë të ngritjes së kapaciteteve të bizneseve, që të jenë në gjendje t'i absorbojnë këto fonde. Në fund, falënderoi ministrin për raportimin e tij.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetare e Komisionit,
Znj.Teuta Sahatqjia**
